

D. 4. Përshkrimi
Të jetë në Gjalë
dt. 22.10.20

KUVENDI
NR 2590 DATE 12.10.20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____ 2020

Lënda: Depozitim Projektrezolutë

Drejtuar: Zotit Gramoz RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT

K Ë T U

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 18 pika 1, të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes për shqyrtim dhe miratim në Kuvend projektrezolutën *“Për miratimin e përkufizimit të përdorshëm për antisemitizmin përcaktuar nga Aleanca ndërkombëtare për përkujtimin e Holokaustit”*, së bashku me relacionin shoqërues të saj, për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

DEPUTETET PROPOZUES

1. Jaulant Balla
2. Blendi Gyllameli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKT - REZOLUTË
PËR MIRATIMIN E PÛRKUFIZIMIT TË PËRDORSHËM PËR ANTISEMITIZMIN
PËRCAKTUAR NGA ALEANCA NDËRKOMBËTARE
PËR PËRKUJTIMIN E HOLOKAUSTIT

Kuvendi i Shqipërisë, duke marrë në konsideratë:

- Rezolutën e Parlamentit Europian “mbi luftën kundër antisemitizmit”, miratuar më 1 qershor 2017 (2017/2692(RSP));
- Deklaratën e Këshillit të Bashkimit Europian “mbi luftën kundër antisemitizmit dhe zbatimin e një përqsasje të përbashkët për çështjet e sigurisë për të mbrojtur më mirë komunitetet dhe institucionet hebraike në Europë”, bërë më 6 dhjetor 2018;
- Konkluzionet e Konferencës së nivelit të lartë mbi luftën kundër antisemitizmit në hapësirën e OSBE-së, organizuar nga Kryesia e rradhës Shqiptare në Tiranë, më 4-5 shkurt 2020;

miraton përkufizimin e përdorshëm mbi antisemitizmin, jo të detyrueshëm ligjërisht, të përcaktuar nga Aleanca ndërkombëtare për përkujtimin e Holokaustit sipas të cilit :

“Antisemitizmi është një perceptim i caktuar për hebrenjtë, i cili mund të shprehet si urrejtje ndaj hebrenjve. Manifestimet retorike dhe fizike të antisemitizmit drejtohen ndaj individëve hebrenj ose jo hebrenj dhe/ose ndaj pronës së tyre, ndaj institucioneve dhe objekteve fetare të komunitetit hebraik.”

Kuvendi vlerëson se:

- përkufizimi i përdorshëm, sikurse është përcaktuar nga Aleanca ndërkombëtare për kujtimin e Holokaustit, në seancën plenare zhvilluar në Bukuresht, më datë 26 maj 2016, në frymën e Deklaratës së Stokholmit që thotë: “Me njerëzimin që ende është i frikësuar nga ... antisemitizmi dhe ksenofobia, komuniteti ndërkombëtar ka një përgjegjësi serioze për të luftuar këto të këqija”, ndihmon për të shquar më qartë e luftuar më me efikasitet antisemitizmin bashkëkohor;

- ky përkufizim përbën një instrument efikas në luftën kundër antisemitizmit në formën e tij moderne për sa i përket manifestimit të urrejtjes ndaj Shtetit të Izraelit justifikuar me perceptimin e tij si një kolektivitet hebraik.

Kuvendi i rekomandon Qeverisë shqiptare:

- të përdorë këtë përkufizim pune mbi antisemitizmin, jo të detyrueshëm ligjërisht, të përcaktuar nga Aleanca ndërkombëtare për përkujtimin e Holokaustit si një instrument orientues në fushën e edukimit si dhe për mbështetjen e autoriteteve juridike dhe ndëshkimore në përpjekjet e tyre për zbulimin dhe goditjen me efikasitet të sulmeve antisemitike.
- të vazhdojë dhe të forcojë luftën ndaj çdo shfaqjeje të intolerancës dhe diskriminimit që mund të çojë në akte urrejtje dhe dhune, përfshirë dhe antisemitizmin;
- të rrisë masat sensibilizuese dhe edukative në kuadrin e luftës kundër manifestimeve të intolerancës dhe diskriminimit, përfshirë dhe antisemitizmin.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratohet, në datë _____

Relacion mbi historikun e përkufizit të përdorshëm pune mbi antisemitizmin, jo të detyrueshëm ligjërisht, të përcaktuar nga Aleanca ndërkombëtare për përkujtimin e Holokaustit

Historia e përkufizimit të punës

Aleanca ndërkombëtare për përkujtimin e Holokaustit (IHRA - International Holocaust Remembrance Alliance) është e vetmja organizatë ndërqeveritare e mandatuar për tu fokusuar vetëm në çështjet që kanë të bëjnë me Holokaustin. Kjo Organizatë, duke pasur prova që rreziku i antisemitizmit është sërish në rritje, vendosi të marrë një rol drejtues për ta luftuar atë. Ekspertët e IHRA-s përcaktuan që, për të nisur adresimin e problemit të antisemitizmit, duhet të jetë e qartë se çfarë është antisemitizmi.

Komisioni i IHRA-s për Antisemitizmin dhe Mohimin e Holokaustit ka punuar për të pasur një konsensus ndërkombëtar rreth një përkufizimi pune të përdorshëm mbi antisemitizmin, që më pas u miratua nga seanca plenare. Me këtë IHRA vendosi një shembull të sjelljes së përgjegjshme për forumet e tjera ndërkombëtare dhe ofroi një mjet të rëndësishëm me zbatueshmëri praktike për vendet e saj anëtare.

Përkufizim Pune i Antisemitizmit

Në frymën e Deklaratës së Stokholmit që thotë: “Me njerëzimin që ende është i frikësuar nga ...antisemitizmi dhe ksenofobia, komuniteti ndërkombëtar ka një përgjegjësi serioze për të luftuar këto të këqija”, komisioni për Antisemitizmin dhe Mohimin e Holokaustit mblodhi në vitin 2015 seancën plenare të IHRA-s në Budapest për të miratuar përkufizimin e antisemitizmit si më poshtë.

Më datë 26 maj 2016, seanca plenare në Bukuresht vendosi të miratojë këtë përkufizim pune mbi antisemitizmin, jo të detyrueshëm ligjërisht:

“Antisemitizmi është një perceptim i caktuar për hebrejnë, i cili mund të shprehet si urrejtje ndaj hebrejve. Manifestimet retorike dhe fizike të antisemitizmit drejtohen ndaj individëve hebrej ose jo hebrej dhe/ose ndaj pronës së tyre, ndaj institucioneve dhe objekteve fetare të komunitetit hebraike.”

Manifestimet mund të përfshijnë shënjestrimin e shtetit të Izraelit, të konceptuar si një bashkësi hebraike. Megjithatë, kritikizmi ndaj Izraelit i ngjashëm me atë që bëhet ndaj çdo shteti tjetër nuk mund të konsiderohet si antisemitik. Antisemitizmi shpesh i akuzon hebrejnë se komplotojnë për ti bërë dëm njerëzimit, dhe shpesh përdoret për të fajësuar hebrejnë për gjërat që shkojnë keq. Ai shprehet në të folur, në të shkruar, në forma vizuale dhe në veprime, si dhe përdor stereotipe dhe tipare negative të karakterit.

Shprehjet bashkëkohorë të antisemitizmit në jetën publike, media, shkolla, vende pune dhe në sferën fetare, duke marrë parasysh kontekstin e përgjithshëm, mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Thirrjet për ndihmë apo justifikimin e vrasjes apo lëndimit të hebrenjve në emër të një ideologjie radikale apo të një pikëpanjese ekstremiste fetare.
- Bërjen e deklaratave të rreme, çnjerezore, demonizuese apo stereotipike për hebrenjtë si të tillë apo për fuqinë e hebrenjve si bashkësi – mund të përmendim veçanërisht por jo vetëm propagandimi i miteve për një komplot botëror hebre apo i hebrenjve që kontrollojnë median, ekonominë, qeverinë e institucione të tjera shoqërore.
- Akuzimin e hebrenjve si një popull që është përgjegjës për keqbërje reale apo të imagjinuara, të kryera nga një person i vetëm ose nga një grup hebrenjsh, apo qoftë dhe për vepra të kryera nga persona që nuk janë hebrenj.
- Mohimin e faktit, objektivave, mekanizmave (p.sh. dhomat e gazit) apo qëllimeve të e Gjermanisë Nacional Socialiste dhe mbështetësve e bashkëpunëtorëve të saj gjatë Luftës së Dytë Botërore (Holokausti) për genocidit ndaj hebrenjve.
- Akuzimin e hebrenjve si popull, apo të Izraelit si shtet, për sajimin ose ekzagjerimin e Holokaustit.
- Akuzimin e qytetarëve hebrenj se janë më besnikë ndaj Izraelit, apo ndaj gjoja përparësive të hebrenjve në të gjithë botën, sesa ndaj interesave të vetë kombeve të tyre.
- Mohimin e së drejtës së popullit hebre për vetë-vendosje, p.sh. duke deklaruar se ekzistenca e një Shteti të Izraelit është një përpjekje raciste.
- Aplikimin e standarteve të dyfishta duke i kërkuar një sjellje që nuk kërkohet apo nuk pritet nga ndonjë vend tjetër demokratik.
- Përdorimin e simboleve dhe imazheve që lidhen me antisemitizmin klasik (si p.sh. hebrenjtë që gjoja vrasin Jezusin apo fëmijet e krishterë) për të karakterizuar Izraelin apo izraelitët.
- Krahasimin e politikës bashkëkohore të Izraelit me atë të nazistëve.
- Bërjen përgjegjës të hebrenjve si bashkësi për veprimet e shtetit të Izraelit.

Aktet antisemitike janë kriminale kur përcaktohen si të tilla me ligj (për shembull, mohimi i Holokaustit apo shpërndarja e materialeve antisemitike në disa vende).

Aktet kriminale janë antisemitike kur shënjestrat e sulmeve, qofshin ato njerëz apo prona – si godina, shkolla, vende kulturi dhe varreza – përzgjidhen sepse janë, apo perceptohen se janë, të hebrenjve apo të lidhura me hebrenjtë.

Diskriminimi antisemitik është mohimi për hebrenjtë i mundësive apo shërbimeve që janë të mundshme për të tjerët dhe është i paligjshëm në shumë vende.